



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 451/ Prot.

Durrës, më 18.02.2026

V E N D I M

Nr. 19, datë 18.02 2026

PËR

“NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 8, DATË 10.02.2025 TË SENATIT AKADEMIK PËR “MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL 2-VJEÇAR, PROGRAM I INTEGRUAR I STUDIMEVE, CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE MASTER PROFESIONAL, PËR VITIN AKADEMIK 2026 – 2027, DHE KRITERET PËR PROGRAMET E REJA QË DO TË OFROHEN NË VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, Durrës”.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 64, VKM Nr. 407 datë 01.06.2016 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar; bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Arsimit nr. 530, datë 15.10.2025 për “Hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Environmental, Cultural and Tourism Economics” në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës me Universitetin “La Sapienza” Rome, Itali”; në Vendimin nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik; në Vendimin nr. 7, datë 30.01.2026 të Senatit Akademik; si dhe në shkresën me Nr. 437/1 Prot, datë 18.02.2026 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në pikën 1 të Vendimit nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik, për miratimin e kriterëve të pranimin të studentëve në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Environmental, Cultural and Tourism Economics”, program i ofruar në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane, për vitin akademik 2026 – 2027, pranë Fakultetit të Biznesit, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Ky vendim i bashkëlidhet dhe është pjesë e pandashme e Vendimit nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik.
3. Për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore, FB
 - Drejtorja e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI





CIKLI I DYTË I STUDIMEVE MASTER SHKENCOR DHE MASTER PROFESIONAL

➤ FAKULTETI I BIZNESIT

Cikli i studimeve	Programi	Kriteret e pranimit
Cikli i dytë i studimeve Master i Shkencave	Environmental, Cultural and Tourism Economics	<i>Si kriter përjashtues:</i> Të zbatohet VKM në fuqi. <i>Si kriter përzgjedhës të pranimit të studentëve:</i> Të jetë renditja e fituesve bazuar te mesatarja e aplikantëve në Bachelor. <i>Gjuha e huaj anglisht, italisht, niveli B1</i>